

Ministria e Financave
Spektori për kontrollin e brendshëm financiar publik
Njësia për harmonizim të revizionit të brendshëm

UDHËZIME

**PËR PUNË TË NJËSIVE TË REVIZIONIT TË BRENDSHËM NGA SEKTORI PUBLIK NË
REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT NË KUSHTET E GJENDJES SË
JASHTËZAKONSHME TË SHKAKTUAR NGA COVID-19**

22 prill viti 2020, Shkup

Të nderuar revizorë të brendshëm,

Të gjithë jemi të prekur nga kriza shëndetësore e shkaktuar nga virusi COVID-19 dhe njëkohësisht për jetën tonë private ashtu edhe për angazhimin tonë profesional i ndjekim udhëzimet dhe masat e dhëna nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim që në mënyrë sa më shpejtë dhe më lehtë ta kapërcejmë këtë gjendje.

Në kushte të kësaj situatë në shtetin tonë, si edhe në botë, mënyra e zbatimit të detyrimeve tona të rregullta të punës ka ndryshuar tërësisht. Përveç kësaj, si Njësi qendrore për harmonizim, në këto momente dëshirojmë t'ju tregojmë se jemi me ju dhe t'ju ndihmojmë në dhënien e këtyre rekomandimeve se si të mund të veproni në një situatë të tillë.

Dëshirojmë të theksojmë se këto rekomandime janë në drejtim të sigurimit të vazhdimësisë në kryerjen e profesionit të revizionit, në kushte të jashtëzakonshme dhe zbatim më të lehtë të detyrimeve tuaja të rregullta, në përputhje me Ligjin e kontrollit të brendshëm financiar publik.

Përveç kësaj, theksojmë se duhet ta ruani cilësinë e revizioneve në përputhje me standardet profesionale.

Shpresojmë që këto udhëzime/rekomandime të jenë të dobishme, ndërsa në varësi të rrethanave dhe nevojave, do t'i azhurnojmë në mënyrë përkatëse.

Ju inkurajojmë të na kontaktoni për t'i lehtësuar problemet tuaja të përditshme të punës.

Njëkohësisht, jemi të hapur për propozimet tuaja për përmirësimin e procesit të zhvillimit të revizioneve të brendshme në kushtet e gjedjes së krizës.

Mbetshi me shëndet të mirë.

Në këtë dokument, udhëzimet dhe rekomandimet tona janë përqëndruar si më poshtë:

I. NJRB, përkatësisht revizorët e brendshëm në këtë periudhë të përkushtohen në përpilimin e Raportit vjetor për aktivitetet e revizionit të brendshëm në vitin 2019

II. Udhëheqësit e NJRB-së/revizorët e brendshëm, në përputhje me situatën e re, të bëjnë vlerësim të ri të rrezikut dhe të bëjnë rishikim të planin vjetor të punës, me ç'rast revizionet do të shtyhen sepse aktualisht nuk ekziston mundësi reale për kryerjen e tyre.

III. Udhëheqësit e NJRB-së, përkatësisht revizorët e brendshëm në këtë periudhë, t'i japin përparësi rolit të tyre të këshillimit për udhëheqësinë, me ç'rast theks i veçantë do t'i vihet rolit këshillues të profesionit të revizionit dhe të ofrojnë vlerë të shtuar me pyetjen "Si mund të ndihmojmë"?

Në cilin drejtim do të zhvillohet aktiviteti juaj i këshillimit:

1. Kuptimi dhe vlerësimi i spektrit të plotë të rreziqeve të menjëhershme që mund të ndikojnë në punën e institucionit në këtë situatë (procesi i menaxhimit të rrezikut është përgjegjësi e udhëheqësisë, por këshilli i revizorëve sa i përket qasjes së tij objektive dhe njohurive të institucionit, padyshim mund të jenë të dobishëm gjatë këtij aktiviteti);

2. Vlerësimi i planeve ekzistuese ose propozim të miratimit të tyre (aty ku nuk ka) të organizatës së menaxhimit të krizave dhe sigurimin e vazhdimësisë së punës;

3. Të këshillohet udhëheqësia, të mendoj "jashtë" nga rreziqet e zakonshme (kjo do të thotë të mendosh edhe për rreziqet e sulmeve sajber/krimin kompjuterik dhe rrezikut të reputacionit);

4. Këshilloni organizatën/udhëheqësinë tuaj që të mendojë në mënyrë afatgjate, përkatësisht të mendojë për implikimet/pasojat e kësaj situate dhe masat e mundshme që do të zvogëlojnë pasojat e tilla në nivelin më të ulët.

Ndikimi i COVID-19 në punën e institucionit dhe ekonominë e përgjithshme në tërësi mund të zgjasë me muaj apo edhe me vite. Organizatat/udhëheqësia duhet të shqyrtojnë dhe të mendojnë se kjo situatë, nëse do të zgjasë më shumë, si do të ndikonte në proceset afatgjata të punës.

5. Gjatë kryerjes së revizioneve edhe në raportet e revizionit, të merren parasysh rreziqet e reja të shkaktuara nga kriza me COVID-19 dhe në të njëjtën të jepen rekomandime për të zvogëluar pasojat e tyre, në drejtim të shtimit të vlerës dhe të përmirësimit të punës së subjektit.

6. Në vazhdimësi ndiqni situatën dhe azhurnoni qëndrimet dhe aktivitetet tuaja në përputhje me kushtet e ngjarjeve reja.

IV. Të kryhet revizion në distancë/me ndihmën e zgjidhjeve moderne teknologjike. Këtë aktivitet mund ta kryeni nëse vlerësoni se janë përmbushur të gjitha kushtet për zbatimin e tij.

Për zbatimin e revizioneve të brendshme në praktikën tonë ekzistojnë dispozita të qarta në Ligjin për kontrollin e brendshëm financiar publik dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tij (në cilën mënyrë të kryhen të gjitha aktivitetet në revizionet individuale), por padyshim që ekzistojnë aktivitete që mund të zbatohen nga distanca, përkatësisht të rregullohet zbatimi i tyre në distancë dhe të respektohen të gjitha hapat dhe procedurat domosdoshme në revizion.

Për shembull:

- Autorizimi - Autorizimi mund të përgatitet dhe nënshkruhet edhe në këto kushte/ai është proces i thjeshtë/dhe në këto kushte nënshkruhen shkresa;
- Hulumtime preliminare – pjesa më e madhe e të dhënave mund të sigurohet në mënyrë elektronike (me e-mail, memorie stik, CD, etj.), me ç'rast do kihet kujdes për mundësimin e sigurisë së tyre;
- Takimi fillestar - mund të mbahet përmes konferencës me video përmes zoom platformave aktuale, skype, mbështetjes me google etj.
- Përgatitja e planit dhe programit të revizionit - mund të bëhet në distancë/përmes konferencës me video ku mund të diskutojnë dhe miratojnë;
- Puna në terren (testimi/përgatitja e procesverbaleve të testit /procesverbalet për gjetjet dhe dokumentet e tjera shoqëruese) - Për revizione më pak të ndërlikuara, këto aktivitete mund të kryhen në pjesë më të madhe përmes punës në distancë (përmes marrjes së dosjeve elektronike, takime të konferencave me video, shtypjen e materialeve dhe dorëzimin e tyre sipas marrëveshjes paraprake);
- Përgatitja e raporteve - pjesa më e madhe mund të përgatitet në distancë, nëse të gjitha aktivitetet e mëparshme janë kryer pa pengesa të shumta;
- Dorëzimi i raporteve vazhdon të jetë në version të letrës dhe dorëzimi elektronik i dokumentit të skanuar. Të gjitha shërbimet e institucioneve vazhdojnë të punojnë edhe në vijim (edhe pse në mënyrë të reduktuar), në të njëjtën kohë duhet të respektohen rekomandimet e sigurisë personale gjatë realizimit të kontakteve me persona tjerë.
- Takimi përfundimtar - mund të mbahet përmes konferencës me video;
- Të gjitha dokumentet së pari mund të miratohen nga ana e udhëheqësit të NJRB-së ose liderit të ekipit në mënyrë elektronike dhe në fund përmes kontakteve/takimeve të reduktuara, të njëjtat të nënshkruhen në mënyrë formale.
- Për kryerje të suksesshme të revizioneve në distancë është e nevojshme të merren parasysh si në vijim:
- Për nivel të kënaqshëm të ekzistojnë kushte teknike dhe teknologjike veçanërisht lidhje të mira interneti, pajisje të sigurt apo të mesme (laptop me kamerë, kufje, mikrofon ose smartfon me performancë mesatare, për mbajtjen e konferencave me video);
- Përmes shkëmbimit të të dhënave elektronike, të kihet kujdes sa i përket sigurisë së tyre (të përdoren mjete për skedare të kriptuara dhe përmes së njëjtës në mesazhe të veçanta të lëshohet skedari, për shembull, në e-mail, ndërsa fjalëkalimi i skedarit përmes sms mesazheve ose të ngjashme, të ruhen shtojcat/provat, ndërsa të fshihen nga porositë elektronike, etj);
- Udhëheqësi i revizionit të bëj orarin e aktiviteteve;
- Të bëjë ndarje të qartë të roleve dhe detyrave midis anëtarëve të ekipit të revizionit, nëse ekziston ekip të revizionit;
- Të bëhen udhëzime interne për komunikim (shkëmbim të informacionit etj.) në varësi të kushteve në secilën NJRB dhe institucion;
- Të emërojë person nga ekipi i revizionit për kontakt, i cili do të marrë dhe shpërndajë informacionet;
- Drejtuesi i revizionit në bazë ditore të mbaj komunikimin me anëtarët e ekipit dhe gjithashtu të jetë i informuar me zhvillimin dhe dinamikën e zbatimit të aktiviteteve.

Vërejtje: Që të mos shfaqen probleme madhore gjatë kryerjes së revizioneve në distancë, propozojmë që fillimisht të zgjidhen revizione më të thjeshta që janë realizuar në vitet e kaluara dhe tashmë pjesa më e madhe e informacioneve të nevojshme për zbatimin e procesit, përkatësisht funksionimi i sistemit është i njohur.

Baza ligjore për kryerjen e këtij aktiviteti:

- **Neni 37** i Ligjit të kontrollit të brendshëm financiar publik, midis të tjerash, rregullon edhe të drejtën tuaj për qasje në të dhënat që ruhen në mënyrë elektronike.
- Standardet për realizimin profesional të revizionit të brendshëm:
 - **Standardi 1220.A2** – Në ushtrimin e kujdesit të duhur profesional, revizorët e brendshëm duhet të marrin parasysh mundësinë e përdorimit të revizionit të bazuar në teknologji dhe në teknika të tjera të analizimit të të dhënave.
 - **Standardi 2330.A2** - Udhëheqësi i njësisë së revizionit të brendshëm duhet të caktojë kushte për ruajtjen e dokumentacionit të angazhimit, pavarësisht mjetit ku ruhet çdo e dhënë. Këto kushte për ruajtjen e dokumentacionit duhet të jenë sipas udhëzimeve të organizatës dhe të gjitha kërkesave pozitive ligjore ose kërkesave të tjera.

V. Ndiqni trajnime online (gjatë kësaj periudhe ka trajnime që zhvillohen në mënyrë elektronike, për shembull, Webinarët të CEF-it)

Personat për kontakt:

- Trajko Spasovski, udhëheqës i Sektorit për kontroll të brendshëm financiar
E-mail: trajko.spasovski@finance.gov.mk, tel: 075/358727;
- Mite Mitevski, udhëheqës i Njesisë për harmonizim të revizionit të brendshëm
E-mail: mite.mitevski@finance.gov.mk, tel: 075/815263;
- Andriana Stepanoska, këshillëtare në Njësine për harmonizim të revizionit të brendshëm
E-mail: andriana.stepanoska@finance.gov.mk;
- Enver Ziberi, këshillëtar në Njësine për harmonizim të revizionit të brendshëm
E-mail: enver.ziberi@finance.gov.mk;
- Aritia Tutarkova, këshillëtare në Njësine për harmonizim të revizionit të brendshëm
E-mail: aritia.tutarkova@finance.gov.mk (këtë periudhë është në pushimin e lindjes)
- Jetmir Ziberi, bashkëpunëtor i ri në Njësine për harmonizim të revizionit të brendshëm
E-mail: jetmir.ziberi@finance.gov.mk

